

Debati parlamentar për pandeminë

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Thënia e vjetër, faktet flasin vetëm, por ato nuk flasin gjithëherë vetë, më së miri mund ta vërejmë në diskursin e sotëm opozitar, me ç'rast kemi një lloj përdorimi jo fort logjik të statistikave dhe përpjekjes për t'i lidhur statistikën me performancën qeverisëse.

Fatmirësisht që nuk kemi pasur raste me fatalitet, të cilat raste pastaj do të shërbenin për të ushqyer një diskurs fatkeqësisht populist që i referohet statistikave me një lloj logjike politike që dhuron brutalisht rregullat e analizës elementare dhe racionale. Për shkak se nuk mund të futen në dy variabla të ndryshme që nuk komunikojnë njëra me tjetrën në një ekuacion. Nuk mund të flitet për rritjen e kurbës në valën e radhës, valën pandemike të radhës pra, dhe t'i atribuosh këtë rritje të kurbës performancës qeverisëse. Sepse rritja e kurbës tashmë është e evidente që në çdo shoqëri, pavarësisht kapaciteteve institucionale për të menaxhuar pandeminë, kanë ndodhur. Pra, është një fakt objektiv. Është një fakt natyror të cilin pastaj përpiqesh ta kontrollosh, por nuk kontrollohet deri në përmasa sa që t'ia marrësh autonominë kësaj force natyrore.

E tash t'ia atribuosh kësaj në shkencë është thjesht të kesh një lloj korrelacioni negativ. Ka në literaturë shumë shembuj ku merren për këso raste. Ta zëmë në një shoqëri ka rritje të numrit të krimeve, po njëkohësisht ka edhe rritje të numrit të tempujve fetarë. Korrelacioni logjik sipas këtij diskursi do të ishte që tempujt ose predikimet fetare po thirrkuan në krim, por nuk është e vërtetë, sepse këto variabla janë futur gabimisht në një ekuacion. Këtu kemi të bëjmë me shpërfilljen e variablës kryesore, që është rritja demografike. Ndërsa në rastin e ekzistues, kur po flasim për pandeminë, kemi të bëjmë pikërisht me atë që rritja e kurbës është një fakt gati thuajse natyror dhe i pakontrollueshëm në çdo valë pandemie.

Sido që të jetë, unë konsideroj që përjashtimisht Qeverisë Kurti 1, të gjitha menaxhimet e mëpastajme institucionale të pandemisë, disi kanë çaluar në ruajtjen e një lloj proporcionaliteti ndërmjet masave të ndërmarra nga njëra anë dhe gjendjes pandemike, në anën tjetër.

Politikat e masave anti-COVID do të duhej ta reflektonin gjendjen e pandemisë, që do të thotë, para se gjithash, duhet të reflektonin rastet me fatalitet edhe rastet me hospitalizim, por njëkohësisht do duhej të reflektonin edhe kapacitetin financiar dhe ekonomik të shtetit që të përballojë valën e pandemisë. Nuk mund të dalësh, thjesht, jashtë lëkurë tënde. Këtë proporcionalitet, unë e kam parë që ka munguar në pothuajse shumicën e menaxhimeve institucionale të pandemisë, prapë po them përpos Qeverisë Kurti 1, për shkak se ka qenë vala e parë e pandemisë, dhe shumë të panjohura e kanë karakterizuar atë valë, dhe është e natyrshme që të shkohej ndoshta, me masa më të ashpra të mbylljes e kështu me radhë. Kam frikën që krejt debatin për pandeminë e kemi reduktuar tej mase, duke u orientuar vetëm në rastet me fatalitet edhe në infeksione, e duke i lënë anash edhe shumë efekte anësore pandemike, e që mund të jenë edhe efekte afatgjata post-pandemike, të tilla si: dhuna, dhuna në familje.

Unë kam informata që ka rritje eksponenciale të dhunës në familje. E kemi lënë anash krimin, që është po ashtu një mundësi reale që për shkak të problemeve financiare që mund të kenë qytetarët mund t'i ekspozohen më pastaj formave të ndryshme të krimit, për të kompensuar deficitet financiare të familjes.

Stresi, frustrimi, një akumulim kolektiv i mllëfit, të gjitha këto efekte mund të jenë afatgjata post-pandemike. Dhe, çka mendoj unë që kemi çaluar si shoqëri, është mungesa e një debati serioz, ku do të përfshiheshin ekonomistët, sociologët, psikologët, punonjësit e shëndetit mendor që ta vënë në kundërpeshë, pikërisht këtë relacionin e masave anti-COVID me gjendjen pandemike, në mënyrë që të shqyrtohet pak më në detaje, sepse nuk është problemi vetëm te një jetë e njeriut që po e humb atje, sepse problemi është shumë më kompleks. Sado që s'ka dilemë që humbja e jetës së njeriut është dhembja e fundme njerëzore e cila nuk mund të tejkalohet dhe nuk mund të zëvendësohet, as nuk mund të imitohet me dhembje të tjera.

Si do që të jetë, unë konsideroj që dy pika duhet të, unë të paktën t'i jap dy rekomandime. Pika e parë ka të bëjë me mbajtjen e maskës në mjedise të hapura. Edhe gjatë Qeverisë Hoti, unë kam kritikuar si një masë e cila e rrezikon e delegjitimitimin e vet Qeverisë, sepse është shumë vështirë të merren vendime, në fakt, është e lehtë të merren vendime, por nëse ti nuk mund t'i zbatosh ato, është më pastaj rrezik i delegjitimitit, por mbi të gjitha, bartja e maskave në mjedise të hapura, është masa më joefektive që me asnjë shkencor nuk është dokumentuar që ka prodhuar ndonjë efekt. Përkundrazi, unë konsideroj që ka prodhuar vetëm kundër-efekte.

Në planin fiziologjik ta zëmë, ka mund të bëjë dëme në organet respiratore, në planin psikologjik kemi parë që ka pasur akumulim stresi nga qytetarët të cilët u ekspozohen ndëshkimeve nga forcat e rendit, sepse ti dënohesh në rrugë duke ecur vetëm, në anën tjetër, i ke në kafene njerëzit që nuk respektojnë as distancën fizike dhe pinë kafe ose çfarëdo qoftë ajo. Unë i bëj thirrje drejtpërdrejti Qeverisë që, thjesht, ta largojë, sepse është masë që nuk ka prodhuar asnjë efekt të mirë, të dobishëm në menaxhimin e pandemisë. Edhe e dyta ka të bëjë me arsimin. Unë kam shfletuar dhe është me të vërtetë çështje shumë e ndjeshme që është e vërteta, por nga ajo që unë kam parë, studimet që janë bërë në Kanada, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës edhe në Japoni, nuk po them që ne mekanikisht mund t'i referohemi këtyre studimeve, por të paktën vetëm për të menduar ndoshta më hollësisht, kur është në pyetje sistemi arsimor, në këto studime nuk është treguar që mbyllja e shkollave ka pasur ndonjë impakt domethënës në menaxhimin efektiv të pandemisë. Përkundrazi, po e citoj Brendon Gathre, epidemiolog dhe ekspert i shëndeti global i Universitetit të Uashingtonit, ai thotë kështu: "Ka shumë gjëra të cilat ne nuk i dimë përkitazi me Omikronin dhe raportin me shkollat, por gjithsesi, për aq sa ka zgjatur pandemia, tashmë është mjaft e qartë se shkollat asnjëherë nuk kanë qenë burimi kryesor i transmetimit të virusit".

UNESCO edhe UNICEF lënë në njëfarë mënyre për të kuptuar, anipse mund të themi që edhe shprehimisht deri diku e thonë, që shkollat duhet të mbesin të hapura ose të paktën duhet të vazhdohet sipas logjikës që shkollat duhet të mbyllen të fundit dhe të hapen të parat. Sipas vlerësimit të UNESCO-s, deri në 17 trilionë dollarë, llogaritet humbja në përfitimet, në të ardhurat jetësore të krejt këtyre gjeneratave të cilat janë duke e përjetuar mbylljen e shkollave.

Prandaj, po them se është fort me rëndësi që të bëhet një analizë ndërmjet efekteve afatgjata post-pandemike me efektet e drejtpërdrejta pandemike, siç është humbja e jetës së njerëzve, gjithmonë duke mos e nënkuptuar që jeta e njeriut si e tillë është më pak e dhembshme sesa efektet e gjata post-pandemike. Mirëpo, është fort e rëndësishme që të bëhet një diskutim serioz, ku të gjithë studiuesit, profesionistët e fushave, mbliidhen edhe bëjnë analiza të cilat pastaj duhet të përkthehen në politika publike të Qeverisë.

Thirrja e fundit që do ta bëja është, sigurisht, vaksinimi edhe të paktën për sektorin e arsimit kisha bërë lutje, apel opozitës që të mos i politizojmë efektet e pandemisë në arsim, ashtu që të mundësojmë liberalizimin sa më të madh dhe ta evitojmë mbylljen e shkollave si taktikë për menaxhimin e pandemisë.

Faleminderit!